



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 89 dhe nenin 91 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, paragrafi 4 dhe paragrafi 5 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 8 të Ligjit numër 03/L-212 të Punës, nenin 5 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) numër 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenin 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Gjakovës, shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Emri i grupit:	Specialistë të Teatrit
Institucioni:	Komuna e Gjakovës
Njësia:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Lloji i pozitave:	Krijues dhe performues i artit dhe kulturës
Data e njoftimit:	26.03.2024
Afati për aplikim:	27.03.2024 – 25.04.2024
Numri i referencës:	01-111/01-4622
Kohëzgjatja e emërimit:	Me afat të caktuar

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- a. Të mësojnë tekstin dhe të mbajnë prova;
- b. Të hulumtojnë dhe lexojnë materiale apo të ndërmarrin aktivitete fizike dhe intelektuale që ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tyre;
- c. Të diskutojnë interpretimin dhe të shfaqin kreativitet;
- d. Të bashkëpunojnë me të tjerët dhe regjisorin;
- e. Të përformojnë drejtpërsëdrejti para publikut;
- f. Të përformojnë në studio apo lokacion tjetër varësisht nga nevojat që paraqet produksioni;
- g. Të incizoj zërin varësisht nga nevoja e produksionit;
- h. Të kujdesen për hapësirën performuese, kostumet dhe rekuizitat;
- i. Të mbajnë në mend tekstin dhe të gjitha funksionet tjera të veprës derisa ajo vepër zyrtarisht del nga repertori apo siç është e specifikuar në kontratë;
- j. Të studiojnë veprën dhe punojnë në mënyrë krijuese për jetësimin artistik në përpunimin e rolit;
- k. Të bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes;
- l. Kryen dhe punë të tjera sipas kërkesës së drejtorit të teatrit në përputhje me natyrën e punës dhe përgatitjen e tij;
- m. Për punën e tij/saj i përgjigjet regjisorit, inspicientit dhe drejtorit të teatrit.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara përmes legjislacionit në fuqi.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë të studimeve universitare në **Fakultetin e Arteve**, drejtimi i **Aktrimit**.
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku **dy (2) vite** përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Pozitat aktualisht të lira:

Nr.	Titulli i pozitës	Koeficienti	Vendi i punës
1.	Aktor	8	Teatri i Qytetit “Hadi Shehu”

5. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në *Qendrën e Informimit*, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në *Zyrën e Pranimit* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rruga “UÇK” numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*

6. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*);
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar (*prezantohet nga kandidati nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur*);
- Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse (*prezantohet nëse kandidati përzgjidhet për emërim*);
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj*);
- Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar e punës është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për shkelje të rënda të pushuar sipas Ligjit për Zyrtarët Publik;
- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (*personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit*);
- Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve.

7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a. Vlerësimi i jetëshkrimit (*deri në 30 pikë*)
- b. Intervista përmes audicionit (*deri në 70 pikë*)

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (<https://kk.rks-gov.net/gjakove/>) dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

9. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- c. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet përmes legjislacionit në fuqi.
- d. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.